



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2408 Prot.

Roskovec, më 30.03 2026

VENDIM

NR 17 .DATË 30.03 .2026

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS DHE  
RAPORTIT TË TRANSPARENCËS NË VENDIMARRJE TË KËSHILLIT TË  
BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2025”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe VKB Nr.20 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike” neni 43 i tij, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e raportit të punës së Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
2. Miratimin e raportit të transparencës në vendimarrje të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
3. Bashkëlidhur këtij vendimi raporti i punës dhe raporti i transparencës në vendimarrje i Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
4. Ngarkohen Strukturat e Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2236/1 Prot

Roskovec, më 24.03.2026

Lënda: Raport për punën e Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025


Të nderuar këshilltarë,

Këshilli i Bashkisë Roskovec i kryen funksionet dhe veprimtarinë e tij duke u mbështetur në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloreve të miratuara nga vet Këshilli. Këshilli ka ngritur 10 Komisione të Përherëshme të cilët duhet të mblidhen sipas natyrës dhe përmbajtjes së projekt-vendimeve që paraqiten në Këshill, si dhe situatave që kërkojnë mbledhjen e komisioneve specifike.

Para se të japim një pasqyrë të detajuar të punës, aktiviteteve dhe vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2025, e rëndësishme për tu theksuar është fakti që çdo vendimmarrje e Këshillit të Bashkisë Roskovec ka synuar të ketë një impakt pozitiv në komunitetin që përfaqëson.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë miratuar gjithësej 72 (shtatëdhjetë e dy) vendime në Këshillin e Bashkisë Roskovec. Po ta krahasojmë me vitin 2024 ku Këshilli kishte miratuar 80 vendime, në vitin 2025 kemi një ulje të numrit të vendimeve, me 8 vendime më pak. Janë organizuar dhe zhvilluar 12 mbledhje Këshilli të cilat kanë qënë të gjitha mbledhje të hapura për publikun. Të gjitha mbledhjet e realizuara kanë qënë mbledhje të radhës sipas parashikimeve në planin vjetor të punës dhe aktiviteteve të Këshillit. Të gjitha mbledhjet e zhvilluara gjatë këtij viti janë transmetuar live në faqen e facebook të Këshillit. Njoftimet e mbledhjeve dhe publikimi e afishimi i tyre është bërë duke respektuar afatet dhe kriteret që përcakton ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 53 pika 4.

Procesverbali i mbledhjes mbahet në përputhje me Ligjin Nr.8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.



Procesverbali i mbledhjes paraardhëse miratohet në fillim të mbledhjes pasardhëse në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar me Vendim Nr.19 datë 27.03.2020.

Në lidhje me 72 vendimet e miratuara në Këshill, 19 vendime kanë qënë akte me karakter normativ dhe 53 vendime akte me karakter individual dhe kolektiv. Vendimet të cilat ishin akte me karakter normativ, pra 19 vendime i kemi dërguar në Prefekturën e Qarkut Fier për verifikim ligjor, pasi në bazë të ligjit Nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut” neni 16 i tij, Prefekti i Qarkut si kompetencë kryesore në lidhje me NJVQV-të ka verifikimin ligjor të akteve normative. Vetëm 1 (një) Vendim nuk është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier dhe në bazë të procedurës ligjore vendimi i cili nuk është konfirmuar nga Prefektura, është anuluar po me vendim Këshilli në mbledhjen e radhës. Vendimet me karakter individual dhe kolektiv pas miratimit në Këshillin e Bashkisë, janë zbardhur brenda afateve ligjore nga Sekretaria e Këshillit dhe kanë hyrë në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6 i tij. Të gjitha vendimet e miratuara sipas karakterit dhe objektivit të tyre u janë shpërndarë administratës së Bashkisë për zbatim.

Vlen të theksohet se nga kontrolli periodik 3 mujor i institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, në lidhje me verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, nuk janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore. Në përfundim të këtyre kontrolleve të ushtruara çdo 3 muaj gjatë vitit 2025, Prefektura shprehet se :

- Gjatë vitit 2025 nuk ka pasur akte normative të padepozituara për verifikim tek Prefekti i Qarkut.
- Aktet me karakter normativ kanë qënë të shoqëruara me relacionet përkatëse.
- Për vitin 2025 nuk ka akte të kundërshtuara për pavlefshmëri, në gjykatë nga Prefekti i Qarkut Fier.

Nisur nga karakteri i vendimeve pjesën më të madhe të vendimeve të miratuara për vitin 2025 e zënë vendimet për problemet sociale dhe familjeve në nevojë me 18 vendime, vijojnë me vendime për problemet financiare me 17 vendime; 15 vendime të vet Këshillit si: për miratim procesverbalesh të mbledhjeve, planet e aktiviteteve të punës, raporte të punës dhe transparencës; 10 vendime për plane vendore dhe strategji zhvillimore ;4 vendime për infrastrukturën dhe investime; 2 vendime dhe dhënie tituj nderi dhe emërtime të rrugëve; 2 vendime për taksat dhe tarifatat vendore si dhe raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm; si dhe 4 vendime të problematikave të ndryshme si lidhje marrëveshje, binjakëzim, krijimi i Këshillit Ekonomik, etj. Nga sa më sipër këto vendimmarrje flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit si organ përfaqësues me Ekzekutivin dhe administratën e Bashkisë Roskovec, për të realizuar zgjidhje sa më efektive të problematikave të paraqitura gjatë vitit 2025.

Të gjitha vendimet e Këshillit janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec. Kjo faqe përditësohet në vazhdimësi me të gjitha informacionet e nevojshme të cilat duhet të publikohen sipas ligjit.



Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar disa mbledhje komisionesh, kryesisht Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit dhe Komisioni i Arsimit. Konstatohet se Komisionet e Këshillit nuk funksionojnë ashtu siç duhet. Komisionet duhet të jenë sa më aktive, dhe duhet të mbledhen me inisiativën e tyre për çështjet që trajtohen në Këshill, sipas tematikës së çështjes. Kjo mbetet detyrë e komisioneve në vazhdimësi.

Këshilli Bashkiak ka të miratuara disa rregullore për funksionimin e punës së tij. Rregulloret e Këshillit përcaktojnë rregullat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Këshillit Bashkiak Roskovec, procedurën e miratimit të vendimeve të Këshillit, të veprimtarisë vendimarrëse, përfaqësuese dhe mbikqyrëse të Këshillit, monitorimin e procesit të zbatimit të vendimeve të Këshillit, si dhe marrëdhëniet e Këshillit me Kryetarin dhe administratën e Bashkisë, me institucionet, agjencitë qeveritare qendrore dhe rajonale, komunitetin, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, si dhe strukturat komunitare, përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe realizimin e detyrave të dhëna me ligj.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës, në fund të çdo mbledhje është lënë një hapsirë kohore për pyetje, diskutime apo komente nga komuniteti, për qytetarët që kanë qënë të pranishëm në mbledhje, ose që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat në shumicën e rasteve kanë marr përgjigje të drejtpërdrejta nga administrata. Në rastet kur duhej më tepër kohë ata i kanë kthyer përgjigjet me shkresë në mbledhjen e radhës. Çdo kërkesë dhe problem që këshilltarët apo qytetarët ngrejnë në mbledhjet e Këshillit protokollohen nga Sekretarja dhe i dërgohen për shqyrtim Kryetares së Bashkisë. Kryetarja këto problematika ua drejton drejtorive përkatëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Në datën 21.10.2025 Këshilli Bashkiak në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta” zhvilloi një sesion informues për komunitetin. Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies organizimi i këtij sesioni informues kishte për qëllim që komuniteti të njihet me gjithë veprimtarinë e Këshillit si: struktura dhe përbërja e Këshillit, rolin e tij përfaqësues, vendimmarrës dhe mbikqyrës; kompetencat e tij; rregulloret, strukturat komunitare; vendimmarrjet për vitet 2024-2025; konsultimet publike; rrugët sesi mund ta ndjekin mbledhjen dhe sesi mund të komunikojnë me Këshillin; drejtimi i kërkesave/ankesave Këshillit etj. Në këtë takim pati një pjesmarrje të kënaqëshme të qytetarëve, të cilëve në fillim të takimit iu vunë në dispozicion fletëpalosje me gjithë materialin e sipërpërmendur si dhe modele të formularit të kërkesë/ankesave sesi ata mund të drejtohen Këshillit. Në përfundim të prezantimit të materialit informues nga Kryetari i Këshillit, qytetarëve të pranishëm iu la një afat kohor për diskutime dhe pyetje të ndryshme.

Rëndësi i është kushtuar edhe bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave me Këshilla të vendeve të tjera. Konkretisht është zhvilluar një vizitë pune për shkëmbim eksperiencash në Komunën e Ururit Itali në muajin Dhjetor 2025, ku në këtë takim kanë marr pjesë si përfaqësues anëtar të Këshillit.

Në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec <https://bashkiaroskopovec.gov.al/> Këshilli Bashkiak ka ndërfaqen e vet, ku është e pasqyruar e gjithë veprimtaria e Këshillit, gjenden të publikuara dhe

përditësuar të gjitha dokumentat e punës së tij. Duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përçimin sa më shpejtë të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët, Këshilli ka faqen e tij në rrjetin social “facebook”, ku bëhen publikime të ndryshme si njoftimet e mbledhjeve dhe të dëgjësave publike, mbledhjet e Kryesisë, pasqyrimi i aktivitetit të Këshillit nëpërmjet fotografive apo videove, etj. Në këtë faqe bëhet transmetimi live i çdo mbledhje të Këshillit.

*Falenderime për kontributin dhe bashkëpunimin e secilit prej jush dhe punë të mbarë për vitin 2026!*

Konc. Sekretar i Këshillit  
Arlinda Hajdini



**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2234/12 prot.

Roskovec, më 24/03/2026

**RAPORTI I TRANSPARENCËS NË VENDIMMARRJE I KËSHILLIT TË  
BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2025**

Referuar ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.146/2014 “Për konsultimin publik”, VKB Nr.20 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike”, Këshilli i Bashkisë si organ përfaqësues, vendimmarrës dhe mbikqyrës ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, të transparencës, për të qënë sa më afër qytetarëve.

Referuar për sa më sipër Këshilli i Bashkisë Roskovec gjatë vitit 2025 ka miratuar 72 vendime në total të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë, në linkun <https://bashkiaroskovec.gov.al/vendimet-e-keshillit>. Këshilli i Bashkisë Roskovec në bashkërendim dhe bashkëpunim me administratën e Bashkisë, sipas kalendarit vjetor të konsultimeve si dhe kërkesave të drejtorive, për vitin 2025 ka zhvilluar në total 31 dëgjesa publike me komunitetin, grupe të interesit si dhe çdo palë tjetër të interesuar për qytetin Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum. Pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit në dëgjesat publike të zhvilluara gjatë vitit 2025 ka qënë e kënaqshme, ka pasur përfaqësues të Këshillit pothuajse në çdo dëgjesë dhe kjo është për tu vlerësuar.

Njoftimet e dëgjesave publike dhe të dokumentave që konsultohen janë bërë sipas përcaktimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për konsultimin publik”. Dëgjesat publike janë realizuar në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë. Të gjitha seancat e konsultimit publik janë pasqyruar në faqen zyrtare të Bashkisë, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Gjatë vitit 2025 në dëgjesa kanë marrë pjesë 861 qytetarë, nga të cilët 251 femra dhe 610 meshkuj, të grupmoshave të ndryshme.

Vlen për tu theksuar se vetëm për Paketën Fiskale për vitin 2026, Buxhetin e vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 Këshilli në bashkëpunim me Bashkinë Roskovec kanë zhvilluar 13 dëgjesa

publike. Këto dëgjesa janë zhvilluar në çdo fshat, ku kanë marr pjesë këshilltarët si përfaqësuesit e Këshillit në bazë të fshatit që ata përfaqësojnë.

Në dëgjesat e zhvilluara janë bërë propozime dhe sugjerime të cilat lidhen me çështje të ndryshme, në varësi të temës së diskutuar. Sugjerimet dhe rekomandimet kryesore dhe më të rëndësishme kanë të bëjnë kryesisht për buxhetin dhe paketën fiskale për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028. Gjithashtu janë dhënë sugjerime dhe rekomandime edhe në dëgjesat e tjera publike që kanë pasur të bëjnë me dokumenta kryesore siç janë planet vendore. Çështjet kryesore të regjistruara në procesverbalet e dëgjesave publike lidhen me investime në rrugët e parcelave bujqësore, investime në infrastrukturën rrugore, problemi i ujsjellësit dhe KUZ-së në disa fshatra, shtimi i koshave, shtimi i ndriçimit, pastrimi i kanaleve, mirëmbajtja dhe investim në disa institucione arsimore etj. Pjesa më e madhe e propozimeve nga komuniteti u reflektuan në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026. Disa nga propozimet e qytetarëve në dëgjesat publike do të reflektohen nga administrata e Bashkisë në PBA-në 2026-2028 sipas mundësive financiare.

Në kuadër të programit të transparencës, çdo vendimmarrje e Këshillit të Bashkisë Roskovec transmetohet live në Facebook, ku nga sondazhet konstatohet se mbledhjet e Këshillit kanë marr mesatarisht mbi 2000 shikime, numër që ka tendencë rritjeje. Këto transmetime janë të aksesueshme për të gjithë publikun.

Në kuadër të transparencës në formën e llogaridhënies, në muajin Tetor 2025 në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta” u organizua një sesion informues i Këshillit të Bashkisë Roskovec, ku u prezantua aktiviteti dhe puna e Këshillit përpara qytetarëve. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 40 qytetarë të grupmoshave të ndryshme nga të dyja gjinitë, përfaqësues të komunitetit Rom, përfaqësues e të rinjve nga qeveria e nxënësve, kryetar të fshatrave etj.

Të gjitha informacionet lidhur me dëgjesat publike për vitin 2025 gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë, në linkun <https://bashkiaroskopovec.gov.al/regjistri-i-konsultimit-publik/>, <https://bashkiaroskopovec.gov.al/konsultimet-publike-3/>, si dhe në rrjetin social “facebook” të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj !

Konc. Sekretar i Këshillit  
Arlinda Hajdini



KRYETAR  
Afrim Plaka

